

V E N D I M
Nr.379, datë 20.5.1996

PËR KËSHILLIN KOMBËTAR TË PUNËS DHE TË ÇËSHTJEVE SOCIALE

Në zbatim të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës” me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ngritjen e Këshillit Kombëtar të Punës dhe të Çështjeve Sociale me qendër në Tiranë pranë ministrit të Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë.

2. Këshilli Kombëtar i Punës dhe i Çështjeve Sociale shqyrton dhe i bën propozime ministrit për çështje që kanë të bëjnë me interesa të përbashkët të punëdhënësve dhe të punëmarrësve, veçanërisht lidhur me politikën dhe legjislacionin e nxitjes së punësimit, formimin profesional, pagat në sektorin privat dhe shtetëror, sigurimet shoqërore, kushtet e punës, shëndetit dhe sigurimit në punë dhe çështjet sociale.

Me qëllim që të përgatisë konsultim të drejtë, Këshillit Kombëtar të Punës dhe Çështjeve Sociale i vihen në dispozicion nga organizatat e punëdhënësve dhe të punëmarrësve, si dhe nga administrata shtetërore të gjitha informacionet dhe të dhënat e nevojshme.

3. Këshilli Kombëtar i Punës dhe i Çështjeve Sociale përbëhet nga 25 anëtarë, 5 anëtarë përfaqësues të Qeverisë, 10 anëtarë përfaqësues të organizatave të punëdhënësve dhe 10 anëtarë përfaqësues të organizatave të punëmarrësve.

Këshilli kryesohet nga ministri i Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë.

Dy nënkryetarët caktohen respektivisht nga përfaqësuesit e punëdhënësve dhe punëmarrësve më të përfaqësuar dhe ricaktohen një herë në dy vjet. Anëtarët ricaktohen një herë në 4 vjet. Këshilli si rregull mbledhet jo më pak se një herë në vit, por ai mund të mbledhet edhe me kërkesën me shkrim drejtuar kryetarit të tij nga shumica e anëtarëve.

4. Këshilli i Ministrave emëron anëtarët - titullarë dhe anëtarë - kandidatë sipas propozimeve të bëra nga organizatat më të përfaqësuara të punëdhënësve dhe punëmarrësve. Propozimet në Këshillin e Ministrave paraqiten nga ministri i Punës.

Përfaqësuesit e Qeverisë në Këshillin Kombëtar të Punës dhe Çështjeve Sociale janë ministri i Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë, ministri i Financave, ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit, ministri i Arsimit dhe ministri i Drejtësisë.

Anëtarët-kandidatë marrin pjesë në seancat e Këshillit, në mungesë të anëtarëve-titullarë.

5. Këshilli Kombëtar i Punës dhe Çështjeve Sociale miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të Këshillit.

Sekretariati i Këshillit sigurohet nga Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë.

6. Pranë Këshillit Kombëtar të Punës dhe Çështjeve Sociale krijohen dhe funksionojnë komisionet trepalëshe të mëposhtme:

- a) Komisioni i Nxitjes së Punësimit
- b) Komisioni i Formimit Profesional
- c) Komisioni i Pagave
- d) Komisioni i Sigurimeve Shoqërore
- e) Komisioni i Kushteve të Punës, Shëndetit dhe Sigurimit në Punë
- f) Komisioni i Çështjeve Sociale.

7. Komisionet trepalëshe kanë për objekt të shqyrtojnë çështjet lidhur me fushat e tyre të kompetencës dhe t'i transmetojnë mendimet dhe konsultimet Këshillit Kombëtar të Punës dhe Çështjeve Sociale për:

- a) orientimin dhe zbatimin e politikave shtetërore në fushat e veprimtarisë respektive të tyre;
- b) projektligjet dhe projektvendimet e Qeverisë që kanë lidhje me fushat e veprimtarisë së tyre.
- c) çështjet për të cilat i është drejtuar atyre për konsultim dhe mendim Këshilli Kombëtar i

Punës dhe Çështjeve Sociale.

Për të arritur këta objektiva, çdo komision mund të ngrejë grupe pune, si dhe mund të thërrasë ekspertë të kualifikuar.

Sekretariati i secilit komision trepalësh do të sigurohet nga administratat respektive nën varësinë e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë.

8. Shpërblimi për pjesëmarrjen në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Punës dhe Çështjeve Sociale, si dhe të komisioneve për anëtarët bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Aleksandër Meksi